



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UJESJELLES KANALIZIME VLORE SH.A
Lagjia “Kushtrimi” Rruga “Arkobaleno” [Tel:033604060](tel:033604060)

Nr. _____ Prot.
Shtojca 15

Vlore me __/05/2020

Autoriteti Kontraktor Sh.a Ujesjelles Kanalizime Vlore
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data: 13.05.2020]

Për: *Operatorin ekonomik “Colombo” sh.p.k, me nr. nipti J82916489E.* Perfaqesuar nga Administratore Diana Laba. Me adrese: Lagjia Kryengritja e Fierit, Rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67, Fier.

* * *

Procedura e prokurimit: “Prodhim Soletina betoni, tubo betoni dhe kapak betoni”, per vitin 2020.

Numri i referencës së procedurës/lotit: Kerkese per propozim (me sistem elektronik).Nr. **REF-51912-02-27-2020**

Fondi limit: 4 547 569 (katër milion e pesëqind e dyzetë e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Burimi i Financimit : Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Vlorë

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Prodhim Soletina betoni, tubo betoni dhe kapak betoni”, per vitin 2020

Kohezgjatja e kontrates: Duke filluar nga momenti i nenshkrimit te kontrates sipas garafikut te punimeve.

Zhvilluar ne: dt. 30.03.2020 Ora 10:00.Vendi: Vendi: www.app.gov.al.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme d

Njoftojme se, sipas raportit perfundimtar te KVO-se Nr.444 Prot dt.12.05.2020, miratuar nga Titullari I AK, kane qënë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi , 2 (dy) operatore ekonomik me ofertat përkatëse si me poshtë:

- 1- Operatori ekonomik “Avduli” sh.p.k, me Nr.Nipti J66703306O, me oferte ekonomike 3 449 840 (tre milion e katërqind e dyzetë e nëntë mije e tetëqind e dyzetë) lekë pa t.v.sh**

2- Operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k, me Nr.Nipti **J82916489E**, me oferte ekonomike 4 422 289 (katër milion e katërqind e njëzetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) **lekë pa t.v.sh**

Pas mbarimit te vleresimit te ofertave eshte arritur ne kete perfundim:
Është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1.Operatori ekonomik “Avduli” sh.p.k, me Nr.Nipti **J66703306O**, me oferte ekonomike 3 449 840 (tre milion e katërqind e dyzetë e nëntë mijë e tetëqind e dyzetë) **lekë pa t.v.sh.**
-Skualifikohet

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik pjesmarres ne prokurim ka mangesi ne dokumentacion :

1.Ne kriteret e vecanta te kualifikimit **2/g**,operatori paraqet vertetim OSHE vetem per nje kontrate (Vlore).Mungon vertetim i debise per kontratat ne Tirane ku sipas QKB ,OE zhvillon aktivitet ne kete Qark.

2.Ne piken 2.3 kapaciteti teknik pika 9 OE deklarone dy inxhinier ndertimi te cilet duhet te jene te siguruar ne list-pagesat janar-tetor2019.Njeri prej tyre eshte me siguracion te pjesshem ne kete periudhe nga 8-22 dite

3. Ne piken 2.3 kapaciteti teknik pika 14/d , nje nga mjetet e kerkuara,konkretisht mjete AA335XF figuron pa foto te mjetit ku te duket qarte targa e tij

Te gjitha dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre.Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti,ose te dokumentave te rreme te pasakta,konsiderohen si kushte per skualifikim.Si e tille oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Avduli ” nuk mund te konsiderohet si e vlefshme.

Eshte kualifikuar Operatori Ekonomik i poshteshenuar:

1. Operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k, me Nr.Nipti **J82916489E**, me oferte ekonomike 4 422 289 (katër milion e katërqind e njëzetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) **lekë pa t.v.sh**

- Operatori ekonomik pjesmarës në këtë procedurë prokurimi eshte paraqitur në tender me te gjithë dokumentacionin e kerkuar nga ana e Autoritetit Kontraktor në Dokumentat Standarte te Tenderit. Duke qënë se ky operator ekonomik I plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim Komisioni I Vleresimit të Ofertave ka proceduar me kualifikimin e Operatorit Ekonomik **“Colombo” sh.p.k.**

Ne momentin e shpalljes se fituesit ne SPE u konstatua nje gabim i bere ne Vleresim ne sistem nga KVO, ku eshte ngaterruar oferta ekonomike e OE pjesemarres ne tender,me proces-verbalin nr.402 prot date 27.04.2020.

Pas konstatimit te kesaj problematike KVO beri rivleresimin e procedures ne sistem ne zbatim te VKM nr.914 date 29.12.2014 per ”Miratim te rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar per zhvillimin e metejshem te kesaj procedure prokurimi

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“Colombo” sh.p.k, me nr.nipti J82916489E**. Perfaqesuar nga Administratore Diana Laba. *Me adrese:* Lagjja Kryengritja e Fierit, Rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67, Fier, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 4 422 289 (katër milion e katërqind e njëzetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) **lekë pa t.v.sh** /pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor SH.A Ujesjelles Kanalizime Vlore, Lagjia “Kushtrimi” Rr.Arkobaleno sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimit. Se bashku me sigurimin e kontrates duhet te sillni, te gjithë dokumentacionin e paraqitur ne tender (original ose fotokopje e noterizuar), I cili verifikohet nga KVO dhe behet pjese e dosjes se tenderit.

Dokumentacioni i listuar me shkrim dhe numer faqesh, duhet te jete i futur ne nje zarf te mbyllur dhe i vulosur me vulen e operatorit/subjektit. Zarfi i dokumentacionit te tenderit duhet te paraqitet brenda afatit te mesiperm, ne sekretarine e SH.A UK Vlore per tu protokolluar. Nëse dokumentacioni i tenderit, pas verifikimit rezulton i rregullt, atëherë do te procedohet brenda afateve ligjore me nënshkrimin e kontratës, nga përfaqësuesit e te dy palëve. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 04.05.2020

Ankesa: ka ose jo Jo
(nëse ka) ka marrë përgjigje në date _____

Dorian Xhelili

Titullar i Autoritetit Kontraktor